

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik: NTSHM “Letamed” & N.T.SH. “Atom – Med” me adresë në Suharekë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit 
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	13.05.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: 08.05.2020, të parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: NTSHM “Letamed” & N.T.SH. “Atom – Med” me adresë në Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME PAISJE MJEKËSORE PËR LABORATOR PËR NEVOJA TË QKMF** – së, me Numër të prokurimit: 623-20-1051-1-2-1, Nr. i brendshëm: 623-20-007-1-2-1, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa të parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: NTSHM “Letamed” & N.T.SH. “Atom – Med” me adresë në Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME PAISJE MJEKËSORE PËR LABORATOR PËR NEVOJA TË QKMF** – së, me Numër të prokurimit: 623-20-1051-1-2-1, Nr. i brendshëm: 623-20-007-1-2-1, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: 05.05.2020, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj Vendimin e miratuar nga Autoriteti Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **FURNIZIM ME PAISJE MJEKËSORE PËR LABORATOR PËR NEVOJA TË QKMF** – së, me Numër të prokurimit: 623-20-1051-1-2-1, Nr. i brendshëm: 623-20-007-1-2-1, dhe mbështetë Vendimin e miratuar nga Autoriteti Kontraktues.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Grup i Operatorëve Ekonomik: NTSHM "Letamed" & N.T.SH. "Atom – Med" me adresë në Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME PAISJE MJEKËSORE PËR LABORATOR PËR NEVOJA TË QKMF** – së, me Numër të prokurimit: **623-20-1051-1-2-1**, Nr. i brendshëm: **623-20-007-1-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: 05.05.2020, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 08.05.2020, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Baza Ligjore për refuzim të kërkesës

Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësimin e ofertave duke bërë ekzaminimin e të gjitha dokumenteve të prezantuara në ofertat e pranuar.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e ofertave ka zbatuar së pari Nenin 60 paragrafi 1.1 Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, sipas Ligjit të Prokurimit Publik.

Autoriteti Kontraktues hedh poshtë pretendimin e OE dhe njëherit konfirmon se A.K Komuna e Rahovecit ka vepruar duke u bazuar së pari në Ligjin e Prokurimit Publik dhe Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik.

Autoriteti Kontraktues ka vepruar sipas **A01 Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik, Neni 40, parag. 40.2 thotë: *Komisioni vlerësues formohet prej rastit në rast. Komisioni i vlerësimit do të vlerësoj tenderët në pajtim me kriteret e specifikuara me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si më i mirë.***

Komisioni Vlerësues ka qenë profesional, ku Kryesuesi i Komisionit të Vlerësimi ka qenë Specialistë i Biokimisë, ku ka konstatuar se OE i rekomanduar për kontratë i plotëson të gjithat Specifikat e Aparatit dhe Parametrat e Aparaturës sipas Dosjes të tenderit.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Kundër këtij vendimi të AK–së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP–së në pajtim me nenin 109 të LPP–së. Ankesa pranë OSHP–së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës se Prokurimit
Komuna e Rahovecit